

L I G J
Nr.8366, datë 2.7.1998

PËR SHËRBIMIN GJEOLGJIK SHQIPTAR (SHGJSH)
(Ndryshuar me ligjin nr. 9221, datë 15.4.2004; nr.10 227, datë 4.2.2010)
(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

(Hequr togfjalësh me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë detyrat, bazat, parimet e organizimit e të drejtimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH).

Neni 2

Përkufizime

(Ndryshuar pika 8 dhe shtuar pika 9/1 me ligjin nr. 9221, datë 15.4.2004)

Në kuptim të këtij ligji:

1. "Shtet" - kuptohet Republika e Shqipërisë.
2. "Qeveri" - kuptohet Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.
3. "Ministri"- kuptohet ministria që mbulon veprimtarinë e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
4. "Ministër"- kuptohet ministri i ministrisë që mbulon veprimtarinë.
5. "Person"- kuptohet një person fizik a juridik.
6. "Mineral"- kuptohet çdo substancë në gjendje të ngurtë, të lëngët e të gaztë që ndodhet në trajtë natyrore mbi ose nën tokë, në ose nën ujë dhe në shkëmb, formuar prej proceseve gjeologjike.
7. "Mineral i dobishëm" - kuptohet përcaktimi i dhënë në pikën 6, duke shtuar se plotëson kushtet gjeologjike, minerare, teknologjike për përdorimin me efektshmëri në degë të ndryshme të ekonomisë.
8. "Ujëra nëntokësore" nënkuptojnë ujërat e zonës së ngopjes, që formojnë shtresa, me dhe pa tryzni.
9. "Basen ujor" - ka kuptimin që jepet në ligjin "Për rezervat ujore".
- 9/1. "Shkenca të tokës" nënkupton të gjitha disiplinat kryesore, si gjeologjinë,

gjeofizikën, gjeokiminë, mineralogjinë, topografinë, pedologjinë.

10. "Kërkim"- kuptohet faza metodike e kryerjes së vërtetimit, studimeve dhe punimeve gjeologjike komplekse, që synon vlerësimin cilësor dhe jep rekomandime për më tej.

11. "Vlerësim" - kuptohet përcaktimi cilësor e sasior i mineralit në përputhje me kërkesat tekniko-ekonomike të çdo stadi studimor.

12. "Agrogjeologji" - kuptohet studimi kompleks i tokës për përdorimin efektiv dhe mbrojtjen e saj.

13. "Autoritet shkencor - kuptohet një person me gradë shkencore, titull shkencor ose veprimtari të gjerë kërkimore-shkencore.

KREU II OBJEKTI I SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR

Neni 3

(Ndryshuar fjalë e togfjalësh me ligjin nr. 9221, datë 15.4.2004)

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është person juridik publik, buxhetor, institucion këshillimor teknik shkencor i shtetit, që me porosi të tij kryen veprimtari në fushën e shkencave të tokës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është në varësi të ministrit dhe e ka selinë e tij qendrore në Tiranë.

Neni 5

Shteti, i përfaqësuar nga ministria, është zotëruesi i vetëm i kapitalit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe ushtron të drejtën e tij si pronar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

(Shtuar fjalë e togfjalësh dhe paragraf me ligjin nr. 9221, datë 15.4.2004; ndryshuar togfjalësh, shtuar togfjalësh dhe fjalia e fundit me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Objekt i veprimtarisë të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar është:

- Vërtetimet, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet gjeologjike sistematike bazë të vendit nëpërmjet kartografimit kompleks të shkallëve të ndryshme në ndihmë të miradministrimit të territorit, burimeve minerare.

- Vërtetimet, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet gjeofizike, gjeokimike, përfshirë sizmikën e cekët (inxhinierike), elektrometrinë, magnetimetrinë, gravimetrinë, radiimetrinë, matjet e emisioneve të radonit në tokë, ujë, ajër, si dhe në mjediset e brendshme, të çdo lloji e shkalle.

- Kërkimi dhe vlerësimi i mineraleve metalore dhe materialeve industriale hidrokarbureve, burimeve ujore nëntokësore, ujërave të pijshëm e industriale, ujërave

mineralë e termale.

- Vrojtimit, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet hidrogeologjike për rivlerësimin e monitorimin e tyre dhe për caktimin e masave për ruajtjen e rezervave ujore nëntokësore.

- Vrojtimit, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet gjeologjike komplekse për mjedisin dhe monitorimin e tij.

- Vrojtimit, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet gjeologo-inxhinierike.

- Vrojtimit, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet agrogjeologjike, studimet për erozionin.

- Vrojtimit, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet e thelluara shkencore për gjeologjinë dhe metalogjeninë.

- Rilevimet topografike të shkalleve të ndryshme dhe matjet gjeodezike.

- Krijimi i bazës së të dhënave gjeologjike e të mineraleve të dobishme, vënia në dispozicion e këtyre të dhënave organeve të pushtetit qendror e lokal dhe subjekteve të tjera të interesuara, përgatitja, publikimi dhe komercializimi i informacionit gjeologjik.

Promovimi i perspektivës së mineraleve të dobishme.

Neni 7

(Shtuar togfjalësh në fund me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Shërbimi Gjeologjik i Shqipërisë ka të drejtë dhe detyrë të grumbullojë në Arkivin Qendror të Gjeologjisë të gjithë informacionin e dokumentacionin e përfutur deri tani dhe atë që do të përfutohet në të ardhmen në fushën e gjeologjisë bazë, të gjeofizikës, gjeokimisë, hidrogeologjisë, gjeologjisë inxhinierike, topogjeodezisë, kampionaturën, mostrat e dublikatet e tyre, të sistemojë, të ruajë, të përpunojë e të informatizojë dhe t'i përdorë (për vete e të tretët) sipas rregullave që përcaktohen në aktet nënligjore.

Në Arkivin Qendror të Gjeologjisë arkivohet informacioni gjeologjik, të cilin zotëuesi i lejes minerare e dorëzon në Drejtorinë e Përgjithshme të Minierave, duke respektuar kërkesat e nenit 110 të ligjit minerar. Në këtë arkiv arkivohet edhe dokumentacioni gjeologjik krahinor që del nga studimet për naftën dhe gazin si dhe dokumentacioni faktik i punimeve gjeologjike, hidro-gjeologjike dhe gjeologo-inxhinierike të çdo natyre, të kryera nga subjekte private apo shtetërore të fazës së projektzbatimit.

Neni 7/1

(Shtuar fjalë e togfjalësh dhe paragraf me ligjin nr. 9221, datë 15.4.2004; ndryshuar me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Agjencia e Ujit dhe Basenit dërgon në Arkivin Qendror të Gjeologjisë një kopje të projektit, pas miratimit të lejes së shpimit dhe një kopje të relacionit, për rezultatet e punimeve të kryera, pas miratimit të lejes së shfrytëzimit nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës.

Neni 8

(Ndryshuar me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Përveç funksioneve të parashikuara në nenet 6, 7 e 7/1, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar kryen shërbime me pagesë për të tretët. Për shërbimet jashtë vendit merret miratimi paraprak i ministrit.

KREU III ORGANIZIMI

Neni 9

(Shfuqizuar me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Neni 10

(Shfuqizuar me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Neni 11

Kompetencat e këshillit drejtues

(Shfuqizuar me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Neni 12

(Shfuqizuar me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Neni 13

Drejtimi administrativ i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar bëhet nga drejtori dhe, në mungesë të tij nga zëvendësdrejtori i përgjithshëm.

Neni 14

(Ndryshuar me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Drejtori dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm emërohen nga ministri.

Neni 15

Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm

(Ndryshuar me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca:

- a) drejton dhe është përgjegjës për menaxhimin e veprimtarisë së institucionit;
- b) përfaqëson Shërbimin Gjeologjik Shqiptar në marrëdhëniet me të tretët.

Neni 16

(Hequr fjalë me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Rregullat e funksionimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar përcaktohen me një rregullore të vecantë që miratohet nga ministri.

Neni 17

(Ndryshuar me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)

Struktura, nivelet e pagave dhe të shpërblimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV MËNYRA DHE BURIMET E FINANCIMIT

Neni 18 *(Ndryshuar me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)*

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar financohet nga buxheti vjetor, si dhe nga të ardhurat për shërbimet për të tretët.

Neni 19

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar paraqet e merr miratim nga ministria dhe organi qeveritar për zhvillimin dhe bashkëpunimin ekonomik për pjesëmarrje në projekte dypalëshe ose shumëpalëshe.

Neni 20 *(Shtuar fjalë me ligjin nr. 9221, datë 15.4.2004; ndryshuar me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)*

Ministri përcakton shërbimet me pagesë për të tretët, që kryhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. Tarifat për çdo shërbim për të tretët miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Të ardhurat e krijuara nga tarifatat për shërbimet për të tretët përdoren nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar me miratimin paraprak të ministrit, për përmirësimin e punës, nëpërmjet blerjes së pajisjeve, mjeteve teknologjike, aparaturave laboratorike, si dhe për kualifikimin, specializimin e shpërblimin e personelit.

Neni 21 **Dispozitë kalimtare** *(Ndryshuar me ligjin nr.10 227, datë 4.2.2010)*

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të drejtat dhe detyrimet e sh.a. “Gjeoalba”, sh.a. “Hidrogeologji” dhe sh.a “Gjeologji-Gjeodezi”, pjesa e dokumentacionit gjeologjiko-inxhinierik dhe gjeodezik të arkivit qendror teknik, si dhe i gjithë dokumentacioni shkencor i këtyre shoqërive i kalojnë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 22

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministria të nxjerrin aktet e nevojshme

nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr., datë .7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**